



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIM TË TORTURËS

lidhur me

vizitën në Qendrën Edukuese - Korrektuese në Lipjan

Për:

- Z. Abelard Tahiri, Ministër**
Ministria e Drejtësisë
- Z. Uran Ismaili, Ministër**
Ministria e Shëndetësisë
- Z. Milazim Gjocaj, Drejtor**
Departamenti i Shëndetësisë në Burgje, Ministria e Shëndetësisë
- Z. Nehat Thaçi, Drejtor i Përgjithshëm**
Shërbimi Korrektues i Kosovës
- Z. Arif Beqa, Drejtor**
Qendra Edukuese Korrektuese në Lipjan
- Z. Hestet Loku, Drejtor**
Qendra Korrektuese në Lipjan

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit më 5 korrik 2018 ka vizituar Qendrën Edukuese - Korrektuese në Lipjan.

Prishtinë, 07 shtator 2018

HYRJE

Mekanizmi Kombëtarë për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejme “MKPT”) i Avokatit të Popullit bazuar në nenin 17 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, mund të vizitojë në çdo kohë dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, si dhe institucionet psikiatrike dhe të kujdesit social.

Bazuar në këtë mandat, MKPT më 5 korrik 2018 e ka vizituar Qendrën Edukuese-Korrektuese në Lipjan (në tekstin e mëtejme “QEKL”). Po ashtu, MKPT ka realizuar vizita Ad Hoc në QEKL gjatë këtij viti.

Në Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve, të cilëve u është hequr liria theksohet se, duhet të ngrihen ambiente paraburgimi të hapura për të miturit. Ambientet e hapura të paraburgimit janë pa masa sigurie, ose me masa sigurie minimale. Numri i të ndaluarve në këto ambiente paraburgimi duhet të jetë sa më i vogël që të jetë e mundur.¹

Ashtu siç theksohet në Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve, në Kosovë tani funksionon një Institucion i tillë, i cili u hap në maj të vitit 2017, ndërtimi i të cilit u financua nga Komisioni Evropian dhe Ministria e Drejtësisë.

QEKL funksionon si një institucion gjysmë i hapur dhe i hapur², për ekzekutimin e masave edukuese dhe dënimeve me gjysmë liri për të miturit meshkuj dhe femra. QEKL zbaton shkallën e mesme dhe të ulët të sigurisë dhe të kontrollit, aq sa është e nevojshme për mbrojtjen e të miturve nga shkaktimi i vetëdëmtimeve apo shkaktimin e dëmit ndaj stafit apo të tjerëve³.

Gjatë vizitës, MKPT u njoftua nga drejtoria se kapaciteti i QEKL është 36 shtretër, momentalisht janë të vendosur 20 të mitur me masë edukuese.

Neni 28, paragrafi 1 i Kodit të Drejtësisë për të mitur nr. 03/L-193, thekson se Gjykata e shqipton masën e dërgimit në një institucion edukativo-korrektues kur i mituri ka kryer veprë penale të dënueshme me burgim prej më shumë se tre (3) vjet dhe ka nevojë për edukim të specializuar dhe kur masa e tillë është në interesin më të mirë të të miturit. Paragrafi 3 i këtij neni parasheh se kohëzgjatja e kësaj mase nuk mund të zgjasë më pak se një (1) vit ose më shumë se pesë (5) vjet.

Qëllimi i masës edukative është që të kontribuojë në rehabilitimin dhe zhvillimin adekuat të kryerësit të mitur, duke ofruar mbrojtje, ndihmë dhe mbikëqyrje, duke siguruar edukim dhe aftësim profesional, duke zhvilluar përgjegjësinë e tij personale dhe kështu duke ndaluar sjelljen recidiviste.⁴

Organizimi i brendshëm ndërtimor dhe programatik i QEKL, synon përmbushjen e qëllimit rehabilitues për të miturit, duke pasur parasysh të drejtën e të miturit për privatësi, stimulim

¹ Paragrafi 30 të Rregullave të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Cilëve u Është Hequr Liria. http://www.unodc.org/pdf/criminal_justice/United_Nations_Rules_for_the_Protection_of_Juveniles_Deprived_of_their_Liberty.pdf

² Neni 113, paragrafi 1 i Kodit të Drejtësisë për të mitur nr. 03/L-193.

³ Neni 4, paragrafi 2 i Rendit të brendëm shtëpiak të QEKL.

⁴ Neni 19, i Kodit të Drejtësisë për të mitur nr. 03/L-193.

shqisor, mundësi për shoqërizim me të miturit e tjerë, edukim dhe arsimim të përgjithshëm dhe profesional, kujdes shëndetësor të duhur, ushqim sipas nevojave për moshën, pjesëmarrje në aktivitete sportive, argëtuese dhe kulturore.⁵

Qëllimi i kësaj vizite ishte monitorimi i respektimit të të drejtave të personave të mitur të privuar nga liria, të cilët gjendeshin në këtë qendër në pajtim me Kodin e Drejtësisë për të Mitur, ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

Gjatë vizitës, në veçanti janë trajtuar çështja e procedurave të pranimit, njohja e të mitur me të drejtat e tyre, trajtimi, kushtet e akomodimit, regjimi, kujdesi shëndetësor, raportet ndërmjet të miturve të burgosur, qasja në arsim, aftësim profesional, rehabilitimi dhe ri integrimi, kontaktet me botën e jashtme, procedurat e parashtrimit të ankesave dhe masat disiplinore të cilat mund t'u shqiptohen sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Kodit të Drejtësisë për të mitur nr. 03/L-193, dhe mënyra e ekzekutimit të tyre.

⁵ Neni 4, paragrafi 3 i Rendit të brendëm shtëpiak të QEKL.

Përbërja e grupit monitorues

1. Ekipi monitorues përbëhej nga: një këshilltar ligjor, një psikologe dhe një mjek.

Bashkëpunimi me MKPT gjatë vizitës

2. Gjatë vizitës së MKPT në QEKL, personeli i shërbimit korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha vendet e vizituara. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe iu mundësuan bisedat me të miturit pa prezencë të zyrtarëve korrektues ose personelit tjetër.

Qendra Edukative Korrektuese

3. Neni 208 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton llojet e institucioneve korrektuese. Në grupin e këtyre institucioneve ligji në fjalë parasheh edhe institucionet edukative korrektuese për ekzekutimin e masave edukative të dërgimit të kryerësit të mitur në institucionin edukativo-korrektues.
4. Qendra Edukative Korrektuese është institucion i tipit gjysmë të hapur dhe të hapur. Sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale institucionet korrektuese të tipit të hapur nuk kanë elemente të sigurisë fizike dhe materiale që e pengojnë arratisjen e personave të dënuar. Sjellja ndaj personave të dënuar bazohet në vetë disiplinën e tyre dhe përgjegjësinë personale, kurse personeli korrektues mbikëqyrë lëvizjen dhe punën e personave të dënuar.⁶
5. Po ashtu, neni 6 i Rregullores (QRK) nr. 14/2016 për Themelimin e Institucioneve Korrektuese për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale në Republikën e Kosovës përcakton themelimin e Qendrës Edukativo Korrektuese në Lipjan, për ekzekutimin e masave edukative, i cili është i tipit gjysmë të hapur dhe të hapur.
6. Neni 113 paragrafi 1 i Kodit të Drejtësisë për të Mitur, shprehimisht përcakton: *“Masa edukative e dërgimit në institucionin edukativ korrektues ekzekutohet në institucionin edukativ korrektues të themeluar për këtë qëllim. Institucioni edukativo korrektues është institucion korrektues i tipit gjysmë të hapur dhe të hapur”*.

Procedurat e pranimit në QEKL

7. Sipas nenit 5 të Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKL, pranimi i të miturve në QEKL bëhet në pajtim me nenin 31 të LESP, me këtë Rend Shtëpiak dhe përshtatshëmrisht me Udhëzimin Administrativ për Pranimin e të Burgosurve dhe vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm.
8. Menjëherë pas pranimit, i mituri i nënshtrohet kontrollit mjekësorë nga personeli mjekësor brenda 24 orëve dhe për te hapet dosja mjekësore.⁷ Pas pranimit, i mituri intervistohet nga punëtori social i cili do të shërbej si menaxher rasti dhe nga psikologu, të cilët hartojnë raportin me vlerësimin fillestar social dhe raportin me vlerësimin fillestar psikologjik.

⁶ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 209.

⁷ Praktika Standarde e Veprimit, dokument i DSHB, Procedurat për pranim për herë të parë në burg-vizita e parë mjekësore.

9. Në objektin e QEKL gjendet zyra e pranimit, ku për momentin në mungesën e zyrtarit të pranimit, pranimin e të miturve e bënë zyrtari ligjorë. Në momentin e pranimit, të miturit informohen për Rregullat e Rendit Shtëpiak, për të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Keqtrajtimi

10. **MKPT nuk ka pranuar asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo përdorim të forcës së tepruar nga të miturit të cilët akomodohen në këtë qendër.**

Kushtet materiale

11. Gjatë vizitës, MKPT ka vizituar të gjitha hapësirat e objektit. Gjithsej janë 4 njësi: 1. Njësia A (zyrat e administratës, kabinetet); 2. Njësia B (banimi për të miturit); 3. Njësia C (salla e sportit); 4. Njësia D (kuzhina).⁸
12. Në katin e parë të bllokut B janë 6 dhoma të banimit me nga dy shtretër, 1 dhomë për të miturit me nevoja të veçanta me dy shtretër, si dhe 2 dhoma të veçimit me nga një shtrat. Ndërsa vetëm pjesa përdhese e katit të parë është e dedikuar për femrat e mitura me kapacitet prej 8 shtretër.
13. Në katin e dytë të bllokut B, janë 7 dhoma banimi me nga dy shtretër si dhe 2 dhoma të veçimit.
14. MKPT ka vërejtur se kushtet ku mbaheshin të miturit e gjinisë mashkullore janë shumë të mira, dhomat janë të pastra, shtretërit e të miturve kishin çarçafë, batanije, dyshekët ishin cilësorë. Dhomat ku qëndronin të miturit ishin të mëdha dhe kishin ndriçim të mjaftueshëm, posedojnë TV, dollapë personale. Secila dhomë kishte tualete të cilat ishin në gjendje të rregullt, të përshtatshme dhe kishin ujë të ngrohtë pa ndërprerë. Po ashtu, dhomat dhe tualetet të cilat ishin të dedikuara për personat me nevoja të veçanta i plotësonin kushtet për këtë kategori. **Në përgjithësi, MKPT konsideron se QEKL i plotëson të gjitha kushtet për akomodim të të miturve.**
15. Gjatë vizitës, MKPT ka vërejtur se të miturit e akomoduar në QEKL, ishin të veshur me rrobat e tyre personale. Kjo është në pajtim me Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve, të cilëve u është hequr liria, të cilat rregulla përcaktojnë që brenda mundësive, të miturit duhet të kenë të drejtë të veshin rrobat e veta.⁹ Ambientet e paraburgimit duhet të sigurojnë që çdo i mitur të ketë veshje personale të përshtatshme për klimën dhe të mjaftueshme për të siguruar shëndet të mirë, dhe që në asnjë mënyrë të mos jenë degraduese apo poshtëruese.

Kushtet materiale në pjesën ku është dedikuar për femrat e mitura

16. Neni 30, paragrafi 3 i Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKL thekson se “*Të miturat vendosen në pavijon të veçantë të QEKL, të veçuara nga të miturit meshkuj dhe mbahen në mbikëqyrjen dhe kujdesin e stafit femëror*”. Gjatë vizitës në këtë qendër, për momentin nuk kishte asnjë të mitur femër të akomoduar. MKPT u informua se në bllokun B, pjesa përdhese e katit të parë ishte dedikuar për femrat e mitura, e cila ka kapacitet 8 shtretër.
17. Kushtet e akomodimit në dhoma e dedikuara për femrat e mitura ishin shumë të mira, dhomat ofronin ndriçim të mjaftueshëm, secila dhomë kishte tualete, të cilat ishin në

⁸ Neni 50, i Rendit të brendshëm shtëpiak të QEKL.

⁹ Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve, cilëve u është hequr liria, paragrafi 36.

gjendje shumë të mirë. Gjithashtu kishte edhe dhoma për personat me nevoja të veçanta me dy shtretër, të cilat po ashtu i plotësonin kushtet për kategorinë e personave me nevoja të veçanta.

Ushqimi

18. Gjatë vizitës në QEKL, MKPT u informua se ushqimi për të miturit në QEKL përgatitet në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan (QPL). Sipas njoftimit të drejtorit, në momentin kur të mbyllet QPL, atëherë do të funksionon kuzhina në QEKL.
19. **MKPT ka pranuar disa ankesa lidhur me sasinë dhe kualitetin e ushqimit i cili u servohet të miturve, të cilët pohuan se është i pamjaftueshëm, si dhe ankesa lidhur me orarin e shpërndarjes së ushqimit.** Sipas të miturve intervali kohorë i shpërndarjes së ushqimit është mjaft i ngushtë (mëngjesi-dreka), dhe shpërndarja e darkës përfundon më herët, afërsisht rreth orës 17:00, ku sipas të miturve shpesh mbesin të uritur gjatë mbrëmjes. Sipas drejtorisë, koha e darkës tanimë ka ndryshuar dhe shërbehet në orën 18.00. MKPT inkurajon autoritetet të jenë të kujdesshëm që ushqimi për të miturit të jetë i bollshëm dhe i përshtatshëm sipas kalorive të kërkuara për rritjen dhe zhvillimin e të miturve, tri herë në ditë me intervale të ndara kohore, në vendin e përcaktuar posaçërisht për këtë funksion.
20. MKPT vëren se Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se i dënuari ka të drejtë në ushqim të përshtatshëm për ruajtjen e mirë të shëndetit dhe fuqisë së tij në tri shujta për çdo ditë të cilat duhet të jenë të llojllojshme dhe ushqyese. Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t'i përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së punës, stinës e kushteve klimatike dhe për aq sa është e mundur, kërkesave të tij fetare dhe kulturore. Po ashtu, ky ligj përcakton obligimin që të dënuarit ti sigurohet ushqimi i caktuar nga mjeku.¹⁰
21. Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve, të cilëve u është hequr liria theksojnë se, çdo ambient paraburgimi duhet të garantoj që çdo i mitur të marrë ushqim të përgatitur në mënyrë të përshtatshme dhe të paraqitur në vakte normale të ushqimit, me atë cilësi dhe sasi që plotëson standardet e dietës, higjienës, dhe shëndetit dhe për aq sa është e mundur, kërkesat fetare dhe kulturore. Çdo i mitur duhet të ketë ujë të pijshëm të pastër në çdo kohë.

Kuzhina

22. **MKPT ka vizituar edhe kuzhinën ku ushqehen të miturit e cila është në gjendje të keqe sa i përket makinerisë për pastrim të enëve dhe kushteve higjienike.** Madje, si pasojë e këtyre kushteve janë vërejtur edhe insekte të cilat qarkullojnë në kuzhinë. Këtë shqetësim e shprehën edhe personeli dhe drejtoria e QEKL të cilët pohuan se planifikohet renovimi i kuzhinës.

Regjimi

23. Regjimi i aktiviteteve të përditshme në ambientet e brendshme dhe të jashtme është e rregulluar me nenin 19 të Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKL-së. Sipas rutinës ditore, gjatë ditëve të punës të miturit zgjohen në ora 6:30, gjatë vikendeve thirrja për zgjim bëhet në ora 8:00. Të miturit kanë mundësi të lëvizin lirisht në ambientet e brendshme si dhe në hapësirat e përbashkëta të ndejës, hapësirat për aktivitete

¹⁰ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, neni 39, paragrafët 1 dhe 2.

sportive, vizitë për në ambulant. Sipas rutinës ditore, mbyllja dhe numërimi bëhet në orën 19:00 me qëllim që në pavijone të mbahet qetësia. Mbyllja dhe fikja e dritave bëhet rreth orës 22:00, gjatë natës prapë bëhet numërimi zyrtar i të miturve, fikja e TV në orën 23:00, ndërsa gjatë vikendeve në orën 24:00.

24. Sipas Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKL-së, të miturit kanë qasje dhe janë të lejuar të frekuentojnë ambientet e jashtme për ajrim apo aktivitete sportive sipas orarit të përcaktuar nga drejtori i QEKL, i cili nuk është më i vogël se 3 orë në ditë. Të miturit të cilët janë nën masën disiplinore të veçimit, kryejnë shëtitjen në ambient të hapur të veçuar nga të miturit e tjerë sipas orarit të përcaktuar enkas për ta.
25. Gjatë vizitës në QEKL, nga të miturit, MKPT u njoftua se ata lëvizin lirshëm në hapësirat e objektit të QEKL, u mundësohet shëtitja jo më pak se 3 orë, gjë që është në pajtim me nenin 139 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur.¹¹ **MKPT nuk ka pranuar ankesa sa i përket respektimit të kësaj të drejte.**
26. Qendra Edukuese Korrektuese në Lipjan posedon Kabinetin e Informatikës të pajisur me kompjuter, bibliotekën e cila është e pasuruar me disa tituj të ndryshëm, romane, kabinetin e shtypshkronjës, gjithashtu të pajisur me makineri adekuate për shtypjen e dizajnëve në bluza, gota; salla e rrobaqepësisë dhe e floktarisë të cilat po ashtu janë të pajisura me mjete adekuate të punës. Të gjitha makineritë, pajisjet janë donacione nga donatorë të ndryshëm si Organizata Gjermane HELP, UNICEF etj.
27. MKPT u informua se vetëm Kabineti i Informatikës është në funksion. Është i angazhuar instruktori për aftësim profesional, i cili është i licencuar. Të miturit që e kryejnë kursin, pajisen me certifikata nga Qendra Kombëtare për Aftësim Profesional. Ekipi monitorues u njoftua nga përgjegjësit e QEKL se kurset kanë filluar në prill të vitit 2018, gjithsej janë 6 nivele-programe aplikative, ndërsa kursi zgjat 5 deri 6 muaj. **Megjithatë, sipas të miturve kursi i informatikës ka kohë që nuk mbahet.**
28. QEKL posedon edhe sallën e sportit e cila është shumë moderne dhe e kompletuar si dhe sallën e fitnesit, e cila po ashtu është e pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme. MKPT gjatë vizitës, ka konstatuar se salla e sportit dhe e fitnesit shfrytëzohen nga të miturit, mirëpo nuk kanë të angazhuar trajner për këto aktivitete sportive. Gjithashtu, rrobaqepësia, floktaria, kabineti i shtypshkronjës nuk janë në funksion pasi që nuk kanë të angazhuar instruktorë për këto fusha. **MKPT inkurajon autoritetet që t'ju mundësojnë QEKL-së angazhimin e instruktorëve profesional dhe adekuat për rrobaqepësi, floktari, shtypshkronjë, fitnes.**
29. MKPT u njoftua se trajnimet profesionale për hidro-instalues, elektro instalues dhe ndërtimtari, të cilat ofrohen në Qendrën Korrektuese në Lipjan (QKL), nuk mund të ofrohen për të miturit e QEKL-së, po ashtu edhe aktivitetet që u ofrohen të miturve në QEKL, (p.sh kursi i informatikës, shfrytëzimi i sallës së fitnesit, sallës së sportit) nuk ju ofrohen të miturve të tjerë të cilët janë të akomoduar në QKL. **Gjatë vizitës, të miturit pohuan se nuk është duke vazhduar programi EQUIP.**

¹¹ Neni 139, paragrafi 1 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, thekson se i mituri ka të drejtë të kalojë të paktën tri (3) orë gjatë ditës në ambient të hapur brenda institucionit.

30. Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës¹² thekson se të miturve të privuar nga liria duhet t'u ofrohet një program i plotë arsimimi, sporti, trajnimi profesional, rekreacioni dhe aktivitetesh të tjera. Edukimi fizik duhet të përbëjë një pjesë të rëndësishme të atij programi. **MKPT konsideron se të miturve të akomoduar në një institucion të tillë duhet t'u shtohen aktivitetet e përditshme të edukimit.**
31. MKPT u njoftua se 12 të mitur vijnë në mësimin në shkollën e mesme në Qendrën Korrektuese në Lipjan (QKL). MKPT ka pranuar ankesa nga të miturit e QEKL-së, se çdo herë kur të shkojnë në shkollë, kontrollohen ashpër nga stafi korrektues. Sipas drejtorit, këto kontrole janë bazike dhe bëhen pasi që QKL është qendër korrektuese e tipit të mbyllur dhe bëhen për arsye të sigurisë.
32. Neni 22, paragrafi 2 të Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKL-së thekson se Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) dhe QEKL, marrin masa për ofrimin e arsimit të detyrueshëm, arsimit të mëtejshëm të përgjithshëm dhe të formimit profesional në shkollat publike që ndodhen në komunitet apo afërsi gjeografike të arritshme me vendndodhjen e QEKL, me qëllim të ofrimit të arsimit kualitativ, të njëjtë me të miturit e lirë, në mënyrë që pas lirit, i mituri të vazhdojë shkollimin pa vështirësi. Paragrafi 4 i këtij neni thekson se Drejtori i QEKL, merr masa që të garantojë regjistrimin e të miturve në shkollat në komunitet dhe të sigurojë transportin ditor për pjesëmarrjen e tyre ditore në programet arsimore të përgjithshme apo të formimit profesional. **MKPT inkurajon SHKK dhe QEKL, të marrin masa për ofrimin e arsimit në shkollat publike ashtu siç parashihet për QEKL.**
33. Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve, të cilëve u është hequr liria theksojnë se autoritetet kompetente duhet të përpiqen vazhdimisht të rrisin ndërgjegjësimin e publikut se kujdesi për të miturit e ndaluar, dhe përgatitja për kthimin e tyre në shoqëri është një shërbim shoqëror me rëndësi të madhe, dhe për këtë qëllim duhet të ndërmerren hapa aktivë për të nxitur kontaktet e hapura midis të miturve dhe komunitetit vendas.¹³
34. Sipas njoftimit të punëtorëve social shumica e të miturve në QEKL janë të angazhuar në punë me pagesë. Nga dokumentacioni i kontrolluar del se nga 20 të mitur të akomoduar në QEKL, 19 prej tyre janë të angazhuar në punë në pastrim dhe kuzhinë.

Kujdesi shëndetësorë

35. Për momentin në shërbimin shëndetësorë është i punësuar vetëm një infermier i cili punon nga ora 8-16, kurse pjesa tjetër e orarit plotësohet nga stafi i mesëm dhe mjeku nga Qendra Korrektuese në Lipjan. Në përgjithësi, njësitë shëndetësore në QEKL i plotëson standardet dhe ofron shërbimet e duhura mjekësore për të miturit e akomoduar aty.

Kontrolli mjekësorë

36. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015 ka theksuar rëndësinë esenciale që kanë kontrollat mjekësore sidomos në rastet e të burgosurve apo të paraburgosurve të sapo-pranuar, jo vetëm për

¹² Pjesë nga raporti i 9-të i Përgjithshëm [CPT/Inf (99) 12], kapitulli VI. Të miturit në heqje lirie, paragrafi 31

¹³ Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve, të cilëve u është hequr liria.

http://www.unodc.org/pdf/criminal_justice/United_Nations_Rules_for_the_Protection_of_Juveniles_Deprived_of_their_Liberty.pdf

identifikimin e sëmundjeve infektive dhe parandalimin e vetëvrasjeve, por edhe nëpërmjet kontributit i cili jepet në aspektin e parandalimit të torturës përmes evidentimit të duhur të lëndimeve.

37. I mituri i sapo pranuar, në pajtim me Praktikën Standarde të Veprimit të Departamentit të Shëndetësisë në Burgje dhe nenin 5 të Rendit Shtëpiak të QEKL, fillimisht kontrollohet nga infermieri dhe pastaj edhe nga mjeku i QEKL. Të gjitha shërbimet shëndetësore të cilat nuk mund të ofrohen në QEKL ofrohen në Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur ose në institucione shëndetësore publike jashtë qendrës korrektuese.

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore

38. MKPT, bazuar në intervistat e zhvilluara me të miturit dhe personelin shëndetësor të QEKL, ka konstatuar se në QEKL respektohet konfidencialiteti gjatë dhënies së shërbimeve mjekësore dhe po ashtu terapia e përshkruar jepet nga personeli mjekësor. Gjatë verifikimit të dokumentacionit, MKPT ka vërejtur se ka pasur raste të vetëlëndimeve të cilat zakonisht janë shkaktuar me pajisjen për rroje e cilat njihet si “BIC”.

Personeli i QEKL

39. Personeli i QEKL në total përbëhet nga 25 persona, të gjithë janë staf civil dhe punojnë në 4 ndërrime. Si personel operativ janë vetëm 3 persona, të cilët i kryejnë bastisjet, i shoqërojnë të miturit etj. Sipas drejtorit, është e vështir të menaxhohet QEKL me 3 zyrtar operativ.
40. Në QEKL janë të angazhuar 2 punëtor social, një zyrtar i arsimit, një praktikant, një instruktorë. Shërbimet psikologjike ofrohen nga psikologu i Qendrës së Paraburgimit në Lipjan (QPL), i cili nuk e ka një orar të rregullt, por vjen sipas nevojës.
41. Paragrafi 81 i Rregullave të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve, të cilëve u është hequr liria¹⁴ përcakton se personeli duhet të jetë i kualifikuar dhe të përfshijë numër të mjaftueshëm specialistësh si edukatorë, instruktorë të profesioneve të ndryshme, këshilltarë, punonjës social, psikiatër dhe psikologë. Këta dhe personeli tjetër i specialistëve duhet të punësohen normalisht në mënyrë të përhershme. Kjo nuk duhet të përjashtojë punonjës me kohë të pjesëshme apo vullnetarë kur niveli i mbështetjes dhe i trajnimit që ata sigurojnë është i përshtatshëm dhe përfitues.
42. Gjatë vizitës, MKPT konstatoi se në përgjithësi ka mungesë të stafit profesionalë si: instruktorë, edukatorë.

Trajtimi i të miturve

43. Në Rendin e Brendshëm Shtëpiak të QEKL-së, theksohet se, menaxheri i rastit bazuar në rekomandimet e grupit multidiciplinorë duhet të hartojë për çdo të mitur një plan individual trajtimi në harkun kohor prej 20-30 ditë nga ardhja e të miturit në Qendër, duke e konsultuar atë me vetë të miturin, i cili duhet të jap miratimin e tij për të. Plani individual i trajtimit nënshkruhet nga menaxheri i rastit dhe me të cilin njoftohet

¹⁴ Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve, të cilëve u është hequr liria.
http://www.unodc.org/pdf/criminal_justice/United_Nations_Rules_for_the_Protection_of_Juveniles_Deprived_of_their_Liberty.pdf

drejtori i QEKL. Plani individual i trajtimit synon rehabilitimin dhe ri-integrimin e të miturit, duke marrë në konsideratë vlerësimin psikologjik, situatën emocionale, situatën sociale dhe familjare, nivelin arsimor, dëshirat dhe mundësitë e tij për të ndjekur kurse profesionale ose për të përparuar në arsim.

44. Gjatë vizitës, ekipi monitorues kontrolloi disa dosje sociale të të miturve dhe konstatoi se plani individual nuk ishte i kompletuar dhe kjo nuk është në pajtim me nenin 116, paragrafi 2 të Kodit të Drejtësisë për të mitur¹⁵ dhe nenit 6, paragrafi 2 i Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKL i cili përcakton se: *“Menaxheri i rastit mbledh grupin multidisiplinorë brenda 10 ditëve pas ardhjes së të miturit në QEKL, i cili përbëhet nga psikologu, edukatori, zyrtari sprovues dhe udhëheqësi i njësisë së zyrtarëve korrektues me qëllim hartimin e Planit Individual dhe të familjes”*.
45. Sipas zyrtarëve social, plani individual nuk është i kompletuar sepse zakonisht mungon psikologu, edukatori, dhe sipas tyre prezent janë vetëm punëtori social dhe përfaqësuesi i shërbimit sprovues. **MKPT inkurajon ekipin multidisiplinorë që të angazhohen seriozisht në hartimin dhe realizimin e planit individual të trajtimit, i cili është çelësi kryesorë për të arritur rehabilitimin dhe ri-integrimin e të miturit.**

Masat disiplinore

46. Sipas legjislacionit në fuqi, dënimet disiplinore që mund t'u shqiptohen të dënuarve janë: qortimi, heqja e beneficionit të caktuar, urdhri për kompensim dhe vetmia¹⁶. Kurse në rastin e të paraburgosurve, mund të shqiptohen dënimet si në vijim: kufizimi apo ndalimi i vizitave apo korrespondencës, përveç kontakteve me avokatin mbrojtës, Avokatin e Popullit dhe misionet diplomatike.
47. Neni 122 paragrafi 1 i Kodit të Drejtësisë për të Mitur përcakton se, dispozitat mbi procedurat disiplinore dhe dënimet të zbatueshme për personat e dënuar me burgim të paraparë në Ligjin mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale zbatohen përshtatshmërisht për të miturin i cili i nënshtrohet masës së dërgimit në institucionin edukativo korrektues. Më tej, në nenin 122 paragrafi 2, shprehimisht theksohet se: **“Të miturit nuk i shqiptohet izolimi në qeli të veçantë si dënim disiplinor”**.
48. Neni 122 i Kodit të Drejtësisë për të Mitur përcakton se i mituri mund të vendoset në njësi të veçantë të institucionit edukativo-korrektues si dënim disiplinor nën kushtet vijuese: periodha e vendosjes në njësinë e veçantë nuk mund të kalojë pesëmbëdhjetë (15) ditë, i mituri nuk vendoset i vetëm në njësinë e veçantë, i mituri ka të drejtën të kalojë së paku tri (3) orë jashtë lokaleve të mbyllura gjatë kohës së lirë, ka qasje në tekste mësimore dhe libra të tjerë, vizitohet nga zyrtari mjekësor dhe edukatori një (1) herë në ditë dhe dy (2) herë në javë nga drejtori i institucionit edukativo-korrektues.
49. Sipas Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKL-së, fillimi i procedurës disiplinore lejohet vetëm për sjelljet e papranueshme siç janë përcaktuar në këtë Rend Shtëpiak, dhe nëse nuk kanë qenë të efektshme metodat e këshillimit individual apo sjellja është e përsëritur apo me pasoja të rënda.

¹⁵ Neni 116, paragrafi 2 i Kodit të Drejtësisë për të Mitur përcakton se i mituri më pas dërgohet në sektorin për kontroll personal por jo më gjatë se gjashtëdhjetë (60) ditë, me qëllim të përpilimit të programit individual. Programi me të cilin do të trajtohet i mituri hartohet nga grupi i ekspertëve dhe nga institucioni edukativo korrektues.

¹⁶ Paragrafët nga 101 deri në 113 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

50. Neni 42, paragrafi 1 i Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKL-së përcakton se Procedurat disiplinore dhe masat disiplinore për të miturin shqyrtohen dhe vendosen nga Drejtori i Institucionit brenda 48 orësh bazuar në të dhënat, informacionin dhe provat e paraqitura nga stafi përkatës. Masat disiplinore zbatohen sipas parimit se masa disiplinore është forma e fundit e disiplinimit të sjelljes.
51. Neni 42, paragrafi 2 i Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKL-së thekson se masat disiplinore që mund t'u shqiptohen të miturve në QEKL janë:
- 2.1 përjashtimi nga veprimtari të veçanta, të përbashkëta deri në 3 ditë;
 - 2.2 përjashtimi nga dalja në ambientet e jashtme në grup për jo më shumë se 5 ditë;
 - 2.3 përjashtimi nga të gjitha veprimtaritë e përbashkëta deri në 10 ditë.
52. Neni 42, paragrafi 7 i Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKL-së thekson se, ndalohet vetmia si masë disiplinore ndaj të miturve. Paragrafi 8 i këtij neni thekson se, veçimi për qëllime disiplinore vendoset vetëm në raste përjashtuese kur sanksionet e tjera nuk kanë qenë efektive. Ky veçim vendoset për një periudhë të përcaktuar kohore, e cila nuk mund të jetë më shumë se 15 ditë. Regjimi gatë këtij veçimi duhet të garantojë vazhdimin e programit arsimor, atij të formimit profesional, punësimit, kontaktet njerëzore, materiale leximi dhe të sigurojë të paktën një orë dalje në ambientet e jashtme për ajrim apo aktivitet fizik individual çdo ditë nëse e lejojnë kushtet atmosferike.
53. Gjatë vizitës, MKPT ka kontrolluar Protokollin për Masë Disiplinore, ku u vërejt se kishte raste kur të miturve ju ka shqiptuar masa e veçimit. QEKL i ka 4 dhoma të veçimit të cilat i plotësojnë kushtet, mirëpo sipas sqarimit të drejtorisë së Qendrës, kur të miturit kanë bërë ndonjë shkelje të rëndë, masën disiplinore të veçimit e kanë mbajtur në QKL, për shkak të mungesës së stafit në QEKL. MKPT realizoi edhe një vizitë tjetër në QEKL dhe u njoftua se tani masën e veçimit të miturit po e mbajnë edhe në QEKL. **MKPT gjatë vizitave të radhës, do ta përcjellë situatën lidhur me këtë çështje.**

Kontakti me botën e jashtme

54. Neni 120 i Kodit të Drejtësisë për të Mitur përcakton se i mituri ka të drejtë të vizitohet së paku një (1) herë në javë minimum deri në një (1) orë nga prindi i tij, prindi adoptues, kujdestari, bashkëshorti, fëmija, fëmija i adoptuar dhe nga të afërmit e tjerë të gjakut në vijë të drejtpërdrejtë ose në vijë anësore deri në shkallën e katërt. I mituri ka të drejtë të vizitohet së paku një (1) herë në muaj nga persona të tjerë të cilët nuk ndikojnë negativisht në ekzekutimin e masës. **MKPT nuk ka pranuar asnjë ankesë nga të miturit lidhur me këtë të drejtë.**
55. MKPT konsideron se kontaktet me botën e jashtme, veçanërisht vizitat nga familja apo të afërmit tjerë, janë të rëndësishme thelbësore në kontekstin e rehabilitimit social të të burgosurve.
56. Sa i përket thirrjeve telefonike, neni 60 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se i dënuari ka të drejtë të bëjë thirrje telefonike. Gjithashtu, neni 37 i Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKL-së e përcakton se i mituri mund të telefonojë çdo person që dëshirojnë nga pajisjet telefonike me pagesë të vendosura në ambientet

e QEKL-së në pajtim me kohën e caktuar për kohëzgjatje të bisedës në Rutinën Ditore. **MKPT nuk ka pranuar ankesa nga të miturit sa i përket kësaj të drejte.**

Procedura e parashtrimit të ankesave

57. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015, ka theksuar se sistemi efektiv i parashtrimit të ankesave është garancia themelore kundër keqtrajtimit në burgje dhe qendra të paraburgimit. Personat e akomoduar në këto qendra duhet të kenë mundësi për të parashtruar ankesë brenda burgut apo qendrës së paraburgimit në mënyrë konfidenciale dhe t'u mundësohet qasja tek autoriteti i duhur.
58. Neni 91 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, përcakton në hollësi procedurën sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Procedura përfshinë edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t'i drejtohet një autoriteti tjetër, që në rastin e tanishëm është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues dhe Ministri i Drejtësisë.¹⁷
59. MKPT ka vërejtur se në dispozicion të të akomoduarve në Qendrën Edukative Korrektuese në Lipjan gjenden kutitë e ankesave të vendosura nga Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës. Po ashtu, të akomoduarit mund t'i drejtojnë ankesë Avokatit të Popullit edhe përmes linjës telefonike pa pagesë (informatat për linjën telefonike janë të vendosura në kutitë e ankesave), postës së rregullt e cila sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale nuk i nënshtrohet kontrollit nëse i adresohet Avokatit të Popullit të Kosovës, si dhe përmes familjarëve të tyre.
60. MKPT ka vërejtur se drejtorja e Qendrës Korrektuese në Lipjan ofron mundësinë adekuate për parashtrim të ankesave dhe kërkesave, i shqyrton ato dhe u dërgon përgjigje të akomoduarve në këtë qendër.

Prandaj, bazuar në gjetjet dhe konstatimet gjatë vizitës, MKPT e Avokatit të Popullit rekomandon si në vijim:

Ministria e Drejtësisë dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës

- **Ushqimi për të miturit të jetë i bollshëm dhe i përshtatshëm sipas kalorive të kërkuara për rritjen dhe zhvillimin e të miturve.**
- **Të bëhen renovimet e duhura në kuzhinë, si dhe të pajiset kuzhina me makineritë e domosdoshme.**

¹⁷ Neni 91, paragrafi 4 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: Në ankimin e paraqitur drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën e shkruar.

- Të shtohen aktivitetet për të miturit dhe të funksionalizohen kabinetet ekzistuese dhe të angazhohen instruktorët adekuat.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,



Hilmi Jashari
Avokat i Popullit